

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Maj 2021



MESAZHI I INSPEKTORIT TË LARTE TË DREJTËSISË ARTUR METANI NË DITËN E DREJTËSISË

“108 vjet më parë nënshkruesit e Pavarësisë dhe etërit e krijimit të shtetit shqiptar hartuan bazën ligjore të organizimit të sistemit gjyqësor në Shqipëri, atë që njihet si “Kanuni i Zhurisë”. Në shenjë respekti për aktin e tyre historik dhe normat juridike të krijuara nga ky akt, 10 Maji kujtohet e nderohet si Dita e Drejtësisë.

Gjej rastin t’i uroj gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve të tjerë që lidhen me drejtësinë, Ditën e Drejtësisë, dhe t’i inkurajoj të gjithë, për më shumë motivim e me shumë angazhim në punën e tyre fisnike.

Është një ditë për të reflektuar mbi udhën e gjatë që ka kaluar shteti e drejtësia shqiptare, për të ardhur në ditët dhe nivelet e sotme. Është dita

për inkurajim e motivim në rrugëtimin sfidues, që sistemi i drejtësisë ka nisur 5 vite më parë, me reformën më të thellë e të dhimbshme, duhet thënë, që ka njohur ndonjëherë.

Natyrisht nuk jemi ende aty ku duhet, por kushtetuta dhe ligji sot nuk krijojnë asnjë mundësi, që institucionet në procesin e vendim-marrjes së tyre të kenë ndikim të paligjshëm, politik apo cdo lloj tjetër. Kjo pavarësi e garantuar me ligj për cdo gjyqtar e prokuror është një fuqi e madhe për të ndikuar në zhvillimin e shoqërisë e konsolidimin e shtetit të së drejtës, ku dhënia e drejtësisë nuk konsiderohet privilegj apo rastësi, por detyrim dhe e drejtë e çdo individ.

Duke respektuar parimet e shenjta të profesionit, duke ruajtur të pastra interesat e dhënies së drejtësisë, cdo gjyqtar e prokuror i bën një shërbim të madh shoqërisë dhe vendit tonë.”



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Z. Artur Metani, në eventin “Dita e Drejtësisë:

108 vjet më parë, nënshkruesit e Pavarësisë dhe etërit e krijimit të shtetit shqiptar, hartuan bazën ligjore të organizimit të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Në shenjë respekti për këtë akt historik dhe normat juridike të krijuara prej tij, 10 Maji kujtohet, nderohet dhe festohet. Kjo nuk do të thotë se sot të harrojmë problemet që ka sistemi dhe nevojën për ta përmirësuar atë, por mendoj se tërë vitin,

Vijon në fq. 2

FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, Z. ARTUR METANI, NË EVEN- TIN “DITA E DREJTËSISË”

për një gjë të tillë flasim dhe përiqemi. Sot është ditë feste dhe reflektimi. Unë gjej rastin t’i uroj magistratëve dhe punonjësve të tjerë që lidhen me drejtësinë, Ditën e Drejtësisë, dhe t’i inkurajoj të gjithë, për më shumë motivim e me shumë angazhim në punën e tyre fisnike.

Gjyqtarët dhe prokurorët kanë një punë të bukur, frymëzuese dhe të vështirë. E tillë është!

E bukur sepse nëpërmjet profesionit të tyre, ata ndihmojnë njerëz për zgjidhjen e problemeve të tyre. Është e bukur sepse me profesionin e tyre, ata janë pjesë e dhënies së drejtësisë, e kësaj vlere të shenjtë dhe vitale për funksionimin e një shoqërie demokratike. Është edhe frymëzuese, pasi shoqëria jonë sot ka nevojë për më shumë gjyqtarë dhe prokurorë, që të tansmetojnë dhe të ngjallin besim dhe optimizëm tek publiku për sistemin e drejtësisë. Është padyshim edhe e vështirë!

Në një shoqëri, ku politika e ka të vështirë të gjejë kufijtë e vet, janë njerëzit e drejtësisë, ata duhet të ruajnë pavarësinë e institucioneve të demokracisë. Janë ata që duhet të ruajnë parimet e ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së institucioneve.

Shpeshherë, këto parime janë delikate dhe të vështira për t’u gjetur në formë të shkruar në Kushtetutë apo ligje të tjera. Por, për këtë arsye, puna e gjyqtarëve dhe e prokurorëve është e bukur dhe e vështirë. Gjet-



ja e frymës dhe shpirtit të ligjit, të kushtetutshmërisë së akteve ligjore dhe mënyrë së sjelljes së institucioneve, ashtu sic janë mësuar në tekste të rinj dhe të vjetër të Aristotelit, të John Lock-ut apo Baronit Monteskie, deri në jurisprudencën e Gjykatave të rëndësishme në botë, si ajo e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, apo Gjykata e Lartë Amerikane, është padyshim një sfidë intelektuale dhe profesionale, intriguese, por dhe e vështirë.

Por, mendoj se nëse udhërrëfyes do të jenë Kushtetuta dhe jo politika, nëse do t’i rezistohet përpjekjeve të politikës apo interesave të tjera, që do të kërkojnë të imponojnë vendimmarrjen dhe paanësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëse do të ruhen të pastra interesat e dhënies së drejtësisë, të shenjta këto për cdo jurist, atëherë, i është bërë një shërbim shumë i madh demokracisë, i është bërë një shërbim shumë i madh vendit.

Nga ana tjetër, mendoj se është e nevojshme, që rëndësia e kësaj pavarësie, të pranohet së pari nga vetë gjyqtarët. Gjyqtari i famshëm amerikan Learned Hand, në vitin 1944 fliste për shpirtin e lirisë dhe shprehej se: “Nëse liria vdes në zemrat e njerëzve atëherë nuk ka kushtetutë, ligje apo gjykatë që ta shpëtojë atë.” Unë dëshiroj t’u them gjyqtarëve, se nëse ata vetë nuk janë të ndërgjegjshëm për forcën e madhe, që i jep pavarësia e dhënies së drejtësisë zhvillimit të shtetit dhe shoqërisë, atëherë as kushtetuta dhe as ligjet nuk mund të bëjnë dot gjë. Nëse vetë magistratët nuk janë të bindur për rëndësinë që ka pavarësia e tyre për konsolidimin e një shoqërie të drejtë, atëherë as kushtetuta dhe as ligjet nuk mund të bëjnë dot gjë.

Gëzuar edhe një herë këtë ditë frymëzuese!

Ju faleminderit!



TRAJNIM I ADMINISTRATËS SË ILD-SË PËR HETIMIN DISIPLINOR

Misioni Euralius V në bashkëpunim me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë organizuan një trajnim me administratën e ILD-së, mbi hetimin disiplinor në Shqipëri. Një vështrim i përgjithshëm i sistemit disiplinor në Shqipëri dhe roli i administratës së ILD-së, ishte në fokus të trajnimit një ditë, që u zhvillua në ambientet e



Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në fjalën përshëndetëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani nënvizoi rëndësinë që ka forcimi i kapaciteteve të administratës, për ecurinë dhe koordinimin e punës me njësinë e inspektorëve dhe atë të ndihmësinpektorëve, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të ILD-së, me vëmendje të posacme për ankesat e qytetarëve. Roli i stafit të administratës, rregullat e brendshme të punës, marrëdhëniet me publikun dhe komunikimi me palët ankuese, u trajtuan me ushtrime praktike gjatë sesioneve të trajnimit. Për pjesëmarësit u bë prezantimi i manualit për hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Aktiviteti i sotëm është pjesë e ciklit të trajnimeve që misioni EURALIUS V po organizon në bashkëpunim me ILD-në, për fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

STATISTIKA

Gjatë muajit **Maj**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **118 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione.


Konkretisht:

109 ankesa janë depozituar nga qytetarët;

9 ankesa kanë ardhur nga institucione publike dhe jopublike.

27 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre apo asistencë në plotësimin e formularëve. **26 takime** me ankues, të cilët janë asistuar gjatë plotësimit të formularëve të ankesave në ambientet e ILD. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer kon-

firmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Prill 2021. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si; shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projekt-vendimet përkatëse.



SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre. Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.


ASKUSH NUK ËSHTË E NUK DO JETË I PAPERKSHËM PARA LIGJIT



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dha një intervistë, në dt. 18 Maj, për emisionin "Breaking" në Top News, me gazetaren Sidorela Gjoni mbi punën 15 mujore të institucionit që drejton.

I pyetur për shkarkimet e

magjistratëve në këto muaj punë me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Metani tha se ky nuk është synimi i institucionit. "Synimi i këtij institucioni është të ndihmojë mesa mundet që sistemi gjyqësor, sistemi i drejtësisë të performojë sa më mirë, në shërbim të interesave të qytetarëve. Dhe këtë ndihmë sistemit të drejtësisë ia jep edhe nëpërmjet inspektimeve individuale, nëpërmjet procedimeve për gjyqtarë të caktuar, por edhe nëpërmjet inspektimeve te-



"Asnjë nuk është i garantuar nga askush. Ligji do zbatohet për të gjithë njëloj, nga më i madhi tek më i vogli, përfshi edhe mua. Askush nuk është imun e nuk do jetë imun, për sa i takon kompetencave që unë kam. "

matike. Ky është mjeti kryesor i askush. Ligji do zbatohet për të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, inspektimet tematike, që do të thotë, zgjidhja e problematikave që sistemi ka sot dhe për këtë arsye unë them, që nuk është qëllim në vetvete masa disiplinore ndaj gjyqtarit, por është gjetja e së drejtës. Pra edhe mbrojtja e interesit qytetar nga njëra anë, por edhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ana tjetër."

Por pavarësia shkon bashkë me përgjegjësinë, nënvizoi z. Metani dhe përpara ligjit, sa i takon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë askush nuk është i paprekshëm. "Asnjë nuk është i garantuar nga

gjithë njëloj, nga më i madhi tek më i vogli, përfshi edhe mua. Të gjithë jemi në një mekanizëm pune e vendimmarrjeje, por edhe kontrolli e monitorimi nga ligji dhe nga organet, që janë caktuar për të kontrolluar punën e gjithkujt. Askush nuk është imun e nuk do jetë imun, për sa i takon kompetencave që unë kam."

I pyetur nëse është e mundur që sot një gjyqtar a prokuror të mos ndikohet nga politika, Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha se kjo sot është e garantuar nga legjislacioni i ri kushtetues për cdo institucion të drejtësisë. "Kushtetuta dhe ligji sot nuk krijojnë asnjë mundësi që

gjyqtarët dhe prokurorët të kenë një varësi nga cdo institucion politik, apo institucione të tjera, që mund t'u bëjnë presion gjyqtarëve e prokurorëve në vendimmarrjet e tyre. Kjo reformë për mua këtë ka sjellë të mirë, që ka krijuar një sistem efikas kundër mundësisë për ndërhyrje apo ndërhyrjeve që mund t'u bëhen gjyqtarëve e prokurorëve në punën e tyre. Kjo është e para. E dyta, ka lidhje me atë që ju thashë më sipër, që këtë pavarësi duhet ta ndiejmë të gjithë vetë. Duhet të ndihemi vetë të pavarur, që të na respektojnë të tjerët, si të pavarur së pari.

[Klikoni për të ndjekur intervistën e plotë.](#)

Mbi inspektimet tematike të datës 21 Maj 2021:

Misioni Euralius V dhe ILD zhvilluan trajnimin e rradhës për fuqizimin e kapaciteteve të inspektorëve, ndihmës inspektorëve e anëtarëve të kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Trajnimi që u zhvillua në qytetin e Korçës kishte në fokus inspektimet tematike dhe inspektimet e gjykatave dhe prokurorive, si një dimension i rëndësishëm i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



INSPEKTIMET TEMATIKE, PRIORITETI I RI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË



Në fjalën e tij në nisje të trajnimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani nënvizoi se tashmë sfida e ILD-së është të kalojë në një tjetër dimension pune, që janë inspektimet tematike. “Inspektimet tematike në gjykatat e prokuroritë e cdo shkalle në vend do të jetë prioriteti i këtij institucioni në vazhdim, përmes identifikimit e zgjidhjes së problematikave, që sistemi ka sot, pa patur qëllim në vetvete masat disiplinore ndaj magistratëve, por për të ndihmuar që sistemi i drejtësisë të performojë sa më mirë, në shërbim të interesave të qytetarëve, duke iu përgjigjur në kohë, me drejtësi dhe paanshmëri nevojave të shoqërisë për drejtësi.

Kjo do realizohet përmes një studimi, inspektimi dhe analize të plotë e profesionale dhe jo individuale, për gjyqtarë e prokurorë.”, tha z. Metani.

Ekspertja e misionit Euralius, Anita Mihailova dhe inspektorja magjistrate e ILD-së, Marsela Pepi prezantuan përvojat e mëparshme të inspektimit në Shqipëri, rregullat kryesore për inspektimet tematike

dhe inspektimet e gjykatave dhe prokurorive, si dhe praktikat më të mira e standardet ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit diskutuan edhe raste praktike inspektimi, si dhe paraqitën propozime për planin e inspektimeve, i cili do pasurohet edhe me propozimet e kërkuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Gjatë trajnimit u prezantua manuali për Hetimin Disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve i hartuar nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertë të misionit Euralius V.

Në këtë trajnim dy ditor morën pjesë edhe përfaqësues të misionit OPDAT në Shqipëri.




ILD DHE OPDAT VIJOJNË TRAJNIMET PËR SJELLJEN E PAPËRSHTATSHME TË MAGJISTRATËVE




Vlerësimi i sjelljes së papërshtatshme të magjistratëve, një këndvështrim nga gjyqësori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte tema e tryezës rumbullake e organizuar në mënyrë virtuale, ku merrnin pjesë njësia e inspektorëve dhe njësia e ndihmës inspektorëve të ILD-së.

Në nisje të trajnimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani evidentoj rëndësinë, që ka organizimi i forumeve të tilla për shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira për adresimin e çështjeve të përbashkëta dhe falenderoi për impenjimin këshilltaren ligjore rezidente të OPDAT, nga Departamenti I Drejtësisë të SHBA, znj. Michelle Lakomy.

Pjesëmarrësit u njohën dhe diskutuan mbi raste dhe praktika konkrete të prezantuara nga z. Christian Kennerly, Këshilltar Ligjor pranë Sekretarisë Gjyqësore të Gjykatës së Apelit, Qarku i Njëmbëdhjetë, në SHBA.




Kjo është tryeza e dytë virtuale që Zyra e ILD zhvillon në bashkëpunim me OPDAT, lidhur me përmirësimin e procesit të pranimit, shqyrtimit dhe veprimit, në bazë të akuzave për sjellje të papërshtatshme nga magjistratët, që ushtrojnë detyrat në institucionet e reja të drejtësisë në Shqipëri.



OPDAT DHE ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me Zyrën Tejoqeanike të Zhvillimit, Asistencës dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) vijuan sesionin e trajnimeve në funksion të fuqizimit të kapaciteteve të ILD-së, për hetimin disiplinor të magjistratëve.



Maj 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë



© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)  [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%ABs%C3%ABs%C3%AB)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%ABs%C3%ABs%C3%AB)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)